

Prof. dr. Aleksandër MEKSI

ALBANIA E KAUKAZIT DHE SHQIPTARËT

Herë pas here në literaturën shkencore, e jo vetëm në të, shfaqet hipoteza se shqiptarët aty ku ndodhen sot, kanë ardhur nga Kaukazi. Një hipotezë e tillë shtrohet përpara studiuesve dhe publikut, duke u nisur nga përmendja nëpër burime të ndryshme historike e një territori me emrin Albani. Dukuria nuk është vetëm shkencore, sepse ajo përdoret dhe nga politika. Kështu në këto 150 vjetët e fundit, kur historia shumë shpesh është në shërbim të politikave nacionaliste afatshkurtër, ajo është keqpërdorur sidomos në Ballkan, ku interesat e shteteve të krijuara më përpara se të tjerët nëpërkëmbnin ato të popujve fqinj që nuk kishin krijuar ende shtetin e tyre. Nuk kursehen në këtë betejë, gjithnjë të humbur pa e nisur, për të përdorur “teza” e “argumente historike”, për të ngritur teori dhe rivendikime territoriale në dëm të të tjerëve. Një rast i tillë është ai i Nikokles, që në disertacionin e tij rimerr këtë tezë, të cilën e hedh poshtë Fallmerayer.¹⁾

Një përdorim të tillë ka dhe ajo për ardhjen e shqiptarëve nga Kaukazi, diku nga shekujt X-XI, me qenë se atëherë shqiptarët përmenden për herë të parë në burimet bizantine me emrin *albanoi-arbanoi* në trojet e sotme. Përgjithësisht historiografia shqiptare dhe jo vetëm ajo, e ka refuzuar këtë pseudoteori në mënyrë intuitive pa u hyrë në brendësi të dhënave historike që lidhen me albanët e Kaukazit. Për studiuesit shqiptarë, me të drejtë, ka mjaftuar teza e prejardhjes ilire dhe autoktonia e shqiptarëve, vazhdimësia e gjuhës dhe të qenit e saj indoevropiane, që vërtetohet nga shumë albanologë.

Është me interes që të hetojmë se kush janë albanët e Kaukazit,²⁾ ku jetonin ato, ku shtrihej shteti i tyre, gjuha që përdornin dhe cili

ishte fati historik i tyre deri në ditët tona.

Përmendja e parë e Albanisë dhe e banorëve të saj, albanëve, është në betejën e Gaugamelës në vitin 331 para erës sonë, kur ata u rreshtuan së bashku me persët kundër ushtrisë së Aleksandrit të Madh³⁾. Ata përmenden në burime të ndryshme si një popull që jeton pranë Armenisë dhe Iberisë (Gjeorgjia e sotme), pra si një entitet politik i rëndësishëm i rajonit të Kaukazit. Për ta ka përmendje të vazhdueshme ndër burimet greke dhe romake, por dhe në ato armene, bizantine, arabe që nga shekulli I deri tek shekulli VIII e më vonë. E megjithatë për këtë popull njihen pak gjëra. Ka fare pak dëshmi gjuhësore dhe pak të dhëna arkeologjike (Mingeçam-Azerbajxhan). Nëse kanë pasur një literaturë të shkruar, ajo sot është e humbur. Kanë mbijetuar vetëm alfabeti dhe pak mbishkrime të fragmentuara e që presin sot e kësaj dite zbrërthimin.

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit janë kryer mjaft studime për këto probleme dhe në përgjithësi, për historinë e gjuhët e popujve, banorëve të lashtë të rajonit të Kaukazit, të nxitura këto studime edhe nga probleme territoriale ndërmjet shteteve të krijuara rishtas pas viteve '90. Po kështu, ndërkohë janë botuar në disa gjuhë burimet historike si dhe janë studiuar ato në mënyrë krahasuese dhe të përbashkët. Po ashtu, sot nuk mungojnë monografitë për historinë e vjetër të popujve të Kaukazit dhe po aq për albanët.

Albanët e Kaukazit, si një popullsi dhe shtet, përmenden gjithnjë në burimet historike krahas armenëve dhe iberëve (gjeorgjianët) me emra të ndryshëm, sipas gjuhës së burimeve:

- greqisht-*alvania*;
- latinisht-*albania*;
- armenisht-*aluank*;
- gjeorgjianshe-*rani*;
- siriane-*aran*;
- medo-persisht-*ar(r)an*;
- arabisht-*arran* ⁴⁾.

Është gjithashtu me interes e dhëna e Stefan Bizantinit, i cili thotë se ata janë *ariani*. Me sa duket termi fillestar duhet të ketë qenë *aran*, prej nga nën ndikimin e armenishtes kemi *alvan-aluan* nga dhe rrjedh greqishtja *alvano*. "Çuditërisht" në të gjitha botimet e burimeve dhe studimet për rajonin dhe në mënyrë të veçantë në

ato për albanët dhe Albaninë e Kaukazit, askush, d.m.th. as dhe një studiues, nuk merret dhe as nuk i ka shkruar në mendje që të gjejë lidhje ndërmjet tyre dhe shqiptarëve, për arsyen e vetme sepse ato as që ekzistojnë.

Për gjuhët e popujve të Kaukazit, Straboni thotë se në qytetin tregtar Dioskuride (Suhumi i sotëm) fliteshin 70 gjuhë, sepse aq ishin fiset që bënin tregti aty, shifër që të tjerë e shpien në 300 e më tej akoma. Udhëtari arab, al-Masudi thotë se, janë aq shumë popuj që vetëm Zoti mund t'i numërojë. Për *albanët* Straboni ⁵⁾ na tregon se ata kanë një mbret, por që janë 26 grupe etnike me gjuhën e vet secili dhe se nxjerrin nën armë 60000 këmbësorë dhe 22000 kalorës (me kaq përballën Pompeun).

Sot aty fliten gjuhët indoevropiane, altaike, semitike e kaukaziane (me shumë nëngrupe, një prej të cilëve gjuhët *lezge*). Për gjuhën e albanëve kemi, siç e thamë alfabetin me 52 shkronja, pak mbishkrime, emrat e muajve, fjalë jo armene në historitë e hershme të armenëve (shek. VII-X), nga të cilat rezultojnë elementë të gjuhës me studimin e të cilave provohen lidhje me atë të Gargark-ve, duke e futur kështu në grupin e gjuhëve lezge dhe i gjenden lidhje me gjuhën e sotme të etnisë Udi, që banon aktualisht në dy fshatra: Vartashen dhe Nidzh, jo shumë larg vendbanimit ku janë bërë gërmimet arkeologjike të sipërpërmendura dhe ku janë gjetur mbishkrimet e gjuhës albane ⁶⁾.

Ndër dëshmitë e vjetra për këtë popull kemi "Historinë e Armenëve" të Moise Khoren-it ⁷⁾, ku përmenden faktet e njohura për Aluan - Alvank, si dhe që në kohën e perandorit Theodos (fundi i shek. IV), Mesrop Mashtoc shkon tek Iberët dhe ju krijoi shkrimin, pastaj tek Alvanët, pranë mbretit të tyre Arsralen dhe peshkopit Jeremia, ku me ndihmën e përkthyesit, priftit vendas Beniamin, pasi studioi gjuhën e tyre krijoi për ta shkronjat për këtë gjuhë të Gargarat'si, guturale, të ashpër, barbare, të ngjirur. ⁸⁾ Të njëjtat të dhëna jep dhe historiani i shekullit VII Movses Kalankatuaci, në veprën e tij "Historia e Aluank", shkruar në shekullin VII dhe vazhduar në shekullin X nga Movses Daskuranci (mundet kryepriifti i *Aluank*). ⁹⁾

Përsa i përket territorit të fiseve të ndryshme (në antikitet ishin 26), që përbëjnë albanët (aluank). Ai shtrihej, sipas të dhënave të shumicës të burimeve historike, nga shpati jugor i pjesës lindore

të vargmalit Kaukaz deri në lumin Kurr, që derdhej në detin Kas-pik, duke pasur në jug (në territoret në krahun e djathtë të lumit) Armeninë dhe në perëndim Iberinë. Gjatë shekujve, shteti i tyre ka pasur shtrirje edhe më të madhe, duke u përfshirë në territore të Armenisë dhe të tjera. Sot këto territore gjeografike bëjnë pjesë në Azerbajxhan.

Së fundi, duhet të flasim për fatin historik të Aluanëve (Albanëve të Kaukazit). Ata dalin që në fillim si një etni e rëndësishme në rajon dhe si një bashkëbisedues i rëndësishëm për romakët, të cilët kuptuan aspektin më karakterizues të tyre si njerëz të kufirit ndërmjet sub-Kaukazit dhe nomadëve të veriut (Hunët dhe Skithët), çka kontribuoi për dhënien e një rëndësie vendit të albanëve, në kontaktet e perëndimit me vendasit. Këto kontakte filluan me grekët dhe vazhduan me Romën, Bizantin dhe persët, që ndërkohë zvogëlonin vendin e Albanëve (Aluanve) në rajon, për t'u pasuar me arabët, me të cilët merr fund pavarësia e tyre që shënon dhe fillimin e një procesi ende të paqartë për studiuesit, atë të shthurjes dhe tjetërsimit kulturo-etnik, që do t'i zhdukë ata si komb nga hapësira e Kaukazit dhe nga skena e historisë. Persët, e sidomos arabët, krijuan njësi administrative më të mëdha, në të cilat albanët me gjithë rolin parësor të tyre nuk qenë në gjendje të afirmohen si komb përtej territorit fillestar të tyre. Në këtë mënyrë shtrirja e nocionit gjeopolitik Aluan-Alban nuk u pasua me mbijetesë në kushtet e pranisë së presionit apo shtytjes ideologjike-kulturore arabe.

Nga kjo tablo kuptohet se nuk ekziston as lidhja më e vogël ndërmjet shqiptarëve (albanitë-arvanitë) me aluanët (albanët e Kaukazit). Lidhja e tyre ka qenë dhe mbetet e sajuar, apo e kërkuar dhe keqdashëse. Aq më tepër kjo, përderisa as edhe një, studiues i Aluanëve dhe i popujve të Kaukazit, gjatë më shumë se një shekulli nuk i ka shkruar në mendje për një lidhje të tillë, sepse realisht ajo nuk ka ekzistuar dhe nuk është e dokumentuar.